

DERI TE:

KËSHILLI MËSIMOR-SHKENCOR TË FAKULTETIT FILOZOFIK TË
UNIVERSITETIT TË TETOVËS

Në bazë të vendimit Nr. 16-156/2 të datës 24.03.2026 të Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Filozofik, për formimin e Komisionit për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës me titull *"Veprimtaria dhe filozofia politike e organizatave të fshehta me karakter çlirimtar në Kosovë 1945-1990"*, të kandidatit Mr. Sc. Fatmir Arifi, si dhe në bazë të nenit 201 të Universitetit të Tetovës, nenit 62 të Rregullores për kushtet, kriteret dhe rregullat e regjistrimit dhe studimit në ciklin e tretë të studimeve-studimet e doktoraturës në Universitetin e Tetovës, Komisioni në përbërje: 1. Prof. Dr. Isak Sherifi, 2. Prof. Dr. Zeqirja Idrizi, 3. Prof. Dr. Zeqirja Rexhepi, 4. Prof. Dr. Kushtrim Ahmeti, dhe 5. Prof. Dr. Qani Nesimi, pasi lexoi materialin në dorëshkrim, Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Filozofik i paraqet këtë:

RAPORT

për vlerësimin e projekt propozimin e tezës së doktoraturës

1. Lënda e hulumtimit

Studimi i këtij disertacioni të kandidatit mr. sc. Fatmir Arifi, me temë *"Veprimtaria dhe filozofia politike e organizatave të fshehta me karakter çlirimtar në Kosovë gjatë viteve 1945-1990"*, ka trajtuar kontekstin e një prej periudhave më të ndërlikuara, më të dhunshme dhe, njëkohësisht, më pak të studiuar në mënyrë sistematike të historisë politike të Kosovës dhe të shqiptarëve nën sundimin e ish-Jugosllavisë. Kjo periudhë historike përfaqëson një hark

kohor vendimtar, në të cilin u kristalizuan jo vetëm format e rezistencës politike shqiptare, por edhe filozofia politike, programet, platformat dhe format e organizimit, të cilat përbënin themelin e projektit çlirimtar, bazuar në parimet e së drejtës për vetëvendosje.

2. Qëllimi i hulumtimit

Në këtë kuadër, ky studim i kandidatit mr. sc. Fatmir Arifi, ka karakter historik dhe shtrihet në kuadrin kohor 1945-1990. Ai trajton veprimtarinë e organizatave të fshehta me karakter çlirimtar të shqiptarëve jashtë Shqipërisë londineze, të cilat kanë luajtur një rol të rëndësishëm në sensibilizimin e të drejtave historike të shqiptarëve nën sundimin e ish-Jugosllavisë e deri në sendërtimin e shtetit të pavarur të Republikës së Kosovës. Ky studim ka për qëllim njohimin, zbardhjen dhe analizimin e këtyre lëvizjeve, si dhe për të kuptuar potencialin dhe mundësinë që ato japin në formimin e një vetëdijeje më të lartë kombëtare për ruajtjen e vlerave kombëtare, të cilat janë të arritura me shumë mund e sakrificë.

3. Kontributi shkencor i hulumtimit

Ky disertacion i kandidatit mr. sc. Fatmir Arifi, mbështetet në argumentimin, se studimi i plotë i veprimtarisë së organizatave të fshehta nuk mund të arrihet pa një analizë të thelluar të asaj që ato kanë përfaqësuar realisht në planin kombëtar, politik dhe ideologjik. Në periudhën kohore kur kanë vepruar këto organizata, nga regjimi komunist jugosllav ato janë cilësuar dhe dënuar si "organizata nacionaliste, irredentiste, separatiste dhe kundërrevolucionare", ndërsa pas rënies së sistemit komunist, nga veprimtaria atdhetare e këtyre organizatave shpeshherë janë stigmatizuar si organizata komuniste, marksiste-leniniste dogmatike. Pikërisht kjo ambivalencë interpretuese e bën të domosdoshëm një rivlerësim shkencor të platformave të tyre, programeve politike dhe kërkesave që ato kanë artikuluar dhe bartur në opinionin e gjerë, për të përcaktuar nëse këto organizata kanë qenë vërtet dogmatike apo, në thelb, kanë pasur karakter nacionalçlirimtar.

4. Fushat shkencore të hulumtimit

Në rrafshin kronologjik, këtë studim kandidati, mr. sc. Fatmir Arifi, disertacionit e tij të doktoraturës me titull "*Veprimtaria dhe filozofia politike e organizatave të fshehta me karakter çlirimtar në Kosovë 1945-1990*", e ndanë në dhjetë kapituj dhe synon të trajtojë në mënyrë tërësore dhe kronologjike proceset kryesore historike që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore e deri në vitin 1990.

Në kapitullin e parë kandidati analizon periudhën e menjëhershme pas Luftës së Dytë Botërore, duke u ndalur te Konferenca e Bujanit dhe vendimet e saj, të cilat përfaqësojnë një moment kyç në artikulumin e së drejtës së shqiptarëve të Kosovës për të drjtës për vetëvendosje, bazuar në Kartën e Atlantikut. Më tej në kuadër të këtij kapitulli, trajtohet Mbledhja e Prizrenit e korrikut të vitit 1945, si instrument i dhunshëm i institucionalizimit të aneksimit të Kosovës brenda Serbisë, si dhe veprimtaria atdhetare e Organizatës Nacional-Demokratike Shqiptare, ONDSH, e cila përbën një nga format e para të rezistencës së organizuar politike shqiptare kundër Jugosllavisë.

Kapitulli i dytë, kandidati, Fatmir Arifi, fokusohet në politikat shtetërore jugosllave, me objektiv shkombëtarizimin e shqiptarëve të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare nën Jugosllavi, përmes projekteve për përmbysjen e raporteve demografike me karakter etnik, siç ishin regjistrimet e manipuluar të popullsisë, politikat arsimore diskriminuese, shpërnguljet e organizuara të dhunshme drejt Turqisë dhe aksionet represive, të njohur si gjoja "mbledhje e armëve". Në kuadër të këtij kapitulli, kandidati ka shpalosur mekanizmat sistematikë të presionit shtetëror mbi ekzistencën etnike dhe kulturore të shqiptarëve.

Në kapitullin e tretë trajtohet faza e dytë e organizimit politik shqiptar, pas asaj të ONDSH-së, që karakterizohet nga pakënaqësia e thellë shoqërore dhe formimi i organizatave të fshehta me karakter çlirimtar, me platforma më të qarta politike, siç ishte Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve, LRBSH, si dhe demonstratat shqiptare të vitit 1968, të cilat padyshim që kanë shënuan një moment të rëndësishëm të artikulumit publik të kërkesave kombëtare.

Në *Kapitulli i katërt*, kandidati, në kuadër të këtij disercioni i kushtom një hapësirë të çmuar themelimit, konsolidimit dhe transformimit të Grupit Revolucionar të Kosovës, GRK, që më pas e ndryshoi emrin në Grupi Marksist-Leninist i Kosovës, GMLK, dhe së fundmi në Organizata Marksiste-Leniniste e Kosovës, OMLK. Ky kapitull analizon strukturën organizative, orientimin ideopolitik të saj, dokumentet programatike dhe lidhjet e organizatës me shtetin amë, Shqipërinë, duke evidentuar rolin e saj qendror në avancimin dhe masivizimin e lëvizjes së fshehtë me karakter çlirimtar.

Në *kapitullin e pestë*, është trajtuar tipologjia e komunikimit të fshehtë e organizatave të fshehta me karakter çlirimtar me masat e gjera popullore, që përfshin komunikimin përmes parullave, trakteve, broshurave të xhepit dhe shtypin e fshehtë, me theks të veçantë te gazeta "Zëri i Kosovës", "Pararoja", "Liria", si mjet të rëndësishme për ndërgjegjësimin dhe mobilizimin politik të masave të gjera popullore.

Në vazhden e këtij studimi, kandidati Fatmir Arifi, në *kapitulli i gjashtë* analizon pabarazinë kushtetuese të Kosovës brenda Federatës Jugosllave, sidomos pas Kushtetutës së vitit 1974, dhe shpërthimin e demonstratave të vitit 1981, të cilat kanë shënuar një kthesë historike, duke e legjitimuar në opinionin e brendshëm dhe të jashtëm kërkesën bosht politike shqiptare për Republikën e Kosovës, mbi parimin e së drejtës për vetëvendosje.

Kapitulli i shtatë trajton përpjekjet për bashkimin e organizatave të fshehta me karakter çlirimtar në Kosovë dhe viset e saj jashtë Shqipërisë londineze, mbi bazën e platformës programatike dhe përbashkuese të "Tezave të Frontit Popullor për Republikën e Kosovës". Në këtë kapitull do të trajtojmë procesin e bashkimit, mosmarrëveshjet mes organizatave, takimet jashtë dhe brenda vendit dhe tentativat për rigjenerim organizativ, pas arrestimeve masive në vitin 1981-1982.

Ndërsa në *kapitullin e tetë* trajtohen masat represive dhe politikat shkombëtarizuese të Federatës Jugosllave dhe Serbisë ndaj shqiptarëve pas vitit 1981, përfshirë projektet shtetërore si: Memorandumin e SANU-s, fushatat nacionaliste serbe, ndryshimet e dhunshme

kushtetuese, grevën e minatorëve të Trepçës dhe zbatimin e doktrinës së ashtuquajtur të “shtetit juridik serb”.

Kapitulli i nëntë i këtij studimi fokusohet në konsolidimin e Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës, LPRK-së, mbledhjet e saj të përgjithshme, programet politike, rezolutat dhe artikullimin e saj mbi parimin e së drejtës për vetëvendosje për sendërtimin e Republikës së Kosovës.

Ndërsa në *kapitullin e dhjetë* dhe të fundit analizohet roli vendimtar i LPRK-së në orientimin e demonstratave të viteve 1989-1990, shpallja e Deklaratës Kushtetuese të 2 korrikut 1990, qëndrimet e republikave federative jugosllave, si dhe përpjekjet për bashkëpunim ushtarak të LPRK-së me Republikën e Kroacisë, në prag të shpërthimit të luftës dhe shpërbërjes së Federatës së Jugosllavisë.

Në tërësinë e tij, ky studim synon të dëshmojë se organizatat e fshehta me karakter çlirimtar nuk ishin spontane, por as instrumente reagimi ndaj represionit, por ishin vazhdimësi e pashkëputur e procesit të Rilindjes Kombëtare shqiptare.

5. Raporti i komisionit për vlerësim të disertacionit të doktoraturës

Pas shqyrtimit të disertacionit të doktoraturës me titull *“Veprimtaria dhe filozofia politike e organizatave të fshehta me karakter çlirimtar në Kosovë 1945-1990”*, të paraqitur nga kandidati Mr. Sc. Fatmir Arifi, komisioni vlerëson se studimi trajton një temë me rëndësi të veçantë shkencore, historiografike, politike dhe shoqërore, duke u përqendruar në një nga periudhat më të ndërlikuara, më të ndjeshme dhe njëkohësisht më pak të trajtuara në mënyrë tërësore në historiografinë shqiptare dhe atë ndërkombëtare, përkatësisht periudhën 1945–1990, që lidhet me veprimtarinë e organizatave të fshehta shqiptare me karakter çlirimtar në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare nën ish-Jugosllavi.

Komisioni vlerëson se kandidati e ka trajtuar këtë temë në kontekstin e zhvillimeve të përgjithshme historike, politike dhe shoqërore të shqiptarëve nën sundimin jugosllav, duke e parë veprimtarinë e organizatave të fshehta jo si fenomene të izoluara historike, por si pjesë e një procesi të gjatë historik, politik dhe organizativ, që lidhet me vazhdimësinë e përpjekjeve të shqiptarëve për liri, vetëvendosje dhe shtetësi.

Në këtë kuadër, disertacioni ka karakter të theksuar historiko-politik dhe analitik, dhe mbështetet në një qasje të gjerë metodologjike, duke përfshirë analizën historike, analizën e dokumenteve arkivore, analizën e shtypit ilegal, analizën e programeve politike të organizatave të fshehta, si dhe analizën e rrethanave politike dhe shoqërore në të cilat kanë vepruar këto organizata.

Komisioni konstaton se kandidati ka arritur të argumentojë se studimi i plotë i veprimtarisë së organizatave të fshehta me karakter çlirimtar nuk mund të bëhet pa analizën e filozofisë së tyre politike, të programeve dhe platformave politike, të strukturës organizative dhe të rolit të tyre në formësimin e kërkesës politike shqiptare për Republikën e Kosovës. Në këtë drejtim, disertacioni nuk mbetet vetëm në nivelin deskriptiv të ngjarjeve historike, por ndërton një kornizë interpretuese dhe analitike mbi rolin historik të këtyre organizatave në procesin e çlirimit dhe të shtetndërtimit të Kosovës.

Komisioni vlerëson gjithashtu se një nga kontributet kryesore të këtij disertacioni është trajtimi i ambivalencës interpretuese që ka ekzistuar rreth këtyre organizatave. Në periudhën e sistemit komunist jugosllav ato janë cilësuar si organizata nacionaliste, irredentiste, separatiste dhe kundërrevolucionare, ndërsa në periudhën pas rënies së sistemit komunist shpeshherë janë interpretuar si organizata komuniste apo marksiste-leniniste dogmatike. Kandidati përmes analizës së dokumenteve programatike, shtypit ilegal dhe dokumenteve arkivore përpiqet të dëshmojë se këto organizata në thelb kishin karakter nacionalçlirimtar dhe veprimtaria e tyre lidhej me realizimin e së drejtës për vetëvendosje.

Një vlerë e veçantë e këtij studimi qëndron në bazën e gjerë burimore mbi të cilën është mbështetur punimi. Disertacioni mbështetet në dokumente arkivore, në dosje gjyqësore, në dokumente të hetuesisë, në shtypin ilegal të organizatave, në programe dhe platforma politike të tyre, si dhe në literaturën historiografike shqiptare dhe të huaj. Komisioni vlerëson se përdorimi i kësaj baze të gjerë dokumentare i jep punimit karakter të mirëfilltë shkencor dhe e bën atë një kontribut të rëndësishëm në historiografinë shqiptare.

Në aspektin teorik dhe metodologjik, kandidati e vendos studimin në kuadrin e teorive të historisë afatgjatë dhe të strukturave historike, duke iu referuar qasjes së historianit Fernand Braudel dhe sociologut Christian de Montlibert, sipas të cilëve dhuna, represioni dhe konfliktet nuk duhet parë si ngjarje të izoluara, por si pjesë e strukturave afatgjata historike. Në këtë

kontekst, organizimi i lëvizjeve çlirimtare paraqitet si reagim strukturor ndaj pushtimit, represionit dhe mohimit të të drejtave kombëtare.

Komisioni vlerëson se kandidati ka arritur të ndërtojë një argument të qëndrueshëm shkencor, sipas të cilit organizatat e fshehta me karakter çlirimtar përfaqësojnë një faktor strukturor dhe të vazhdueshëm në zhvillimet politike në Kosovë, dhe jo fenomene episodike apo spontane. Sipas këtij argumentimi, këto organizata luajtën rol të rëndësishëm në transformimin e kërkesës politike shqiptare nga një autonomi formale drejt kërkesës për Republikën e Kosovës dhe për të drejtën e vetëvendosjes.

Komisioni vlerëson se struktura e disertacionit është e ndërtuar në mënyrë logjike dhe kronologjike dhe përfshin një periudhë të gjerë historike nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore deri në shpalljen e Republikës së Kosovës në vitin 1990. Punimi është i ndarë në dhjetë kapituj, në të cilët trajtohen proceset kryesore historike, politike dhe organizative të lëvizjes ilegale shqiptare, duke filluar nga periudha e pasluftës, Konferenca e Bujanit, Organizata Nacional-Demokratike Shqiptare, politikat represive jugosllave, formimi i organizatave të fshehta, demonstratat e viteve 1968 dhe 1981, bashkimi i organizatave ilegale, themelimi dhe veprimtaria e Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës, si dhe zhvillimet politike që çuan në shpalljen e Republikës së Kosovës në vitin 1990.

Komisioni vlerëson se një nga përfundimet kryesore të disertacionit është se shpallja e Republikës së Kosovës më 2 korrik 1990 nuk ishte rezultat i rastësishëm i rrethanave ndërkombëtare, por rezultat i një procesi të gjatë historik dhe politik, të ndërtuar mbi veprimtarinë e organizatave të fshehta me karakter çlirimtar, të cilat për më shumë se katër dekada e mbajtën gjallë dhe e zhvilluan kërkesën politike për Republikën e Kosovës.

Në përfundim, komisioni doktorat vlerëson se disertacioni paraqet një punë të mirëfilltë shkencore, me rëndësi të veçantë për historiografinë shqiptare, për studimet politike dhe për studimin e historisë së Kosovës në periudhën 1945–1990. Punimi paraqet kontribut origjinal shkencor, si në aspektin e trajtimit të temës, ashtu edhe në aspektin e interpretimit të rolit të organizatave të fshehta me karakter çlirimtar në procesin historik të çlirimit dhe të shtetndërtimit të Kosovës.

6. Vlerësimi dhe rekomandimi i komisionit

Duke u bazuar në vlerësimin e përgjithshëm shkencor të disertacionit, në metodologjinë e përdorur, në burimet e shfrytëzuara, në strukturën e punimit dhe në përfundimet e arritura, të kandidatit mr. sc. Fatmir Arifi, komisioni doktoral vlerëson se disertacioni i plotëson të gjitha kriteret shkencore dhe akademike për mbrojtje publike. Prandaj, komisioni doktoral ka nderin që të propozojë Këshillit Mësimor- Shkencor të Fakultetit Filozofik miratimin e këtij raporti dhe krijimin e kushteve për mbrojtje publike të këtij disertacionit dhe, pas mbrojtjes me sukses, t'i jepet grada shkencore Doktor i Shkencave në fushën e Historisë.

Komisioni:

Prof. Dr. Isak Sherifi, anëta




Prof. Dr. Zeqirja Idrizi, anëtar



Prof. Dr. Zeqirja Rexhepi, anëtar



Prof. Dr. Kushtrim Ahmeti, anëtar



Prof. Dr. Qani Nesimi, Mentor



Tetovë, 2026